



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

“FIGURA E SKËNDERBEUT NDËR
VITE,
ÇËSHTJE DISKUTIMI PËR
ALBANOLOGËT”

Konferencë shkencore ndërkombëtare në kuadër të vitit
Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot - Skënderbeut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Viti 2018 është një vit i rëndësishëm përkujtimor për Skënderbeun, Heroin Kombëtar të shqiptarëve, i shpallur edhe nga qeveria shqiptare si Viti i Skënderbeut. Në këtë kuadër, duke qenë se epoka e Skënderbeut dhe figura e tij zënë vend të posaçëm në studimet albanologjike, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, do të organizojnë një konferencë shkencore ndërkombëtare, e cila do t'i kushtohet në veçanti kësaj figure shumë dimensionale të kombit shqiptar me temë:

“Figura e Skënderbeut ndër vite, çështje diskutimi për albanologët”

Qëllimi dhe objektivat e Konferencës:

Qëllimi i kësaj konference është ofrimi i një debati dhe diskutimi të gjerë e gjithëpërfshirës në lidhje me figurën dhe epokën e Skënderbeut në botën mbarëshqiptare e më gjerë, duke krijuar hapësirë për diskutime në fusha të ndryshme që përmbledh epoka e Skënderbeut dhe sot, sikurse janë: historia, gjuha, letërsia, shkolla si institucion, gjuhët e huaja, si dhe këndvështrime psikologjike e sociale të kësaj figure dhe epoke.

Për arritjen e qëllimit të saj, konferenca fton që të bashkohen akademikë, kërkues, ekspertë të fushës së filologjisë, politikbërës dhe vendimmarrës, metodistë, didak dhe mësues të specialiteteve të ndryshme, psikologë, punonjës socialë, përfaqësues të OJF-ve që operojnë në fushën e arsimit dhe kulturës, studentë, si dhe ish të diplomuar në profile studimi që trajton konferenca.

Aktiviteti është i hapur për pjesëmarrës të tjerë që shfaqin interes për të përcjellë informacion, apo eksploruar dhe mbështetur zhvillimet në fushën e albanologjisë. Konferenca inkurajon pjesëmarrjen e studentëve, të cilët aspirojnë të ndjekin studimet universitare në fusha të ndërlidhura me filologjinë, edukimin dhe arsimin.

Temat kryesore dhe nëntemat e konferencës:

Konferenca fokusohet në disa tema kryesore studimi që paraqesin interes kërkimor e shkencor mbi studimet albanologjike rrethe pokes së Skënderbeut, jo vetëm në fushat kryesore të tilla si: gjuhësi, studime letrare, histori, por edhe në fusha të ndërlidhura me njëra – tjetrën dhe pjesë integrale me studimet filologjike të tilla si: arsimit, shkolla etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Nga kjo perspective, në conference mire priten shumëllojshmëri punimesh origjinale që hedhin dritë dhe hulumtojnë çështje të mprehta ndër disiplina rreth kësaj figure dhe epoke të rëndësishme për kombin tonë. Nëntemat më të spikatura, por jo të kufizuara, mund të jenë:

- Folklor
- Etnografi
- Histori e gjuhës
- Ndihmesa për njohjen e gjuhës shqipe
- Kontribute të studiuesve që inkurajojnë dhe vlerësojnë figurën e Skënderbeut
- Burimet arkivore
- Organizimi politik në shtetin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut
- Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e drejta
- Studime kritike të trashëgimisë albanologjike për epokën e Skënderbeut
- Arsimi
- Shkolla si një mjedis komunitar dhe social që ndikon në vlerësimin e figurave kombëtare
- Arkeologji
- Arte figurative etj.

FORMATI I KONFERENCËS:

Format e prezantimit në konferencë do të jenë:

- Prezantim oral.
- Prezantim me poster përmes dokumenteve / prezantimeve të tyre në dhoma të veçanta.

ABSTRACT:

- Abstraktet duhet të dërgohen në gjuhën shqip ose anglisht.
- Format i A4, marxhina lart-poshtë 2.5 cm, majtas djathtas 2.5cm, (normal)
- Titulli i punimit shqip dhe anglisht: Font (14pt Times New Roman, bold, në qendër)
- Emri i autorëve (Me shkronjatëmëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)
- Institucioni apo Departamenti, Fakulteti, Universiteti, etj: 12pt Times New Roman, në qendër.
- E-mail: 12pt Times New Roman, në qendër.
- Teksti 250-300 fjalë, 12pt Times New Roman, normal, justify.
- Abstrakti duhet të jetë në përputhje me një nga fushat e studimit, të përmbajë metodologjinë e përdorur, rekomandimet e mundshme Brenda fokusit të studimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

- Fjalë kyç: 5-7 fjalë, 12pt Times New Roman, normal, justify.
- Formulari i Aplikimit duhet të jetë si më poshtë: **emri i UNIVLORA2018abstrakt** dërguar me postë elektronike në **sekretariaekonf@yahoo.com**

PUNIMI

- Punimi duhet të shtypet, me një hapësirë 1.0, në format me madhësi standarde A4, me Margins 1" në të gjitha anët.
- Punimi duhet të përfshijë katër seksione kryesore: Faqja e Titullit, Abstrakti, Trupi Kryesor dhe Referencat.
- Faqja e titullit: Duhet të përmbajë titullin e letrës, emrin dhe mbiemrin e autorit, përkatësinë institucionale, adresën e plotë dhe adresën e postës elektronike. Ne rekomandojmë që titulli juaj të jetë jo më shumë se 12 fjalë në gjatësi dhe se ajo nuk duhet të përmbajë shkurtesat ose fjalët që nuk kanë asnjë qëllim. Titulli juaj mund të zgjasë një ose dy rreshta.
- Abstrakt: siç u shpjegua më sipër.
- Trupi Kryesor: Është pjesë e rëndësishme e punimit dhe do të përfshijë të gjitha çështjet që pasqyrohen në përmbledhjen e abstraktit nga hyrja, qëllimi i studimit / hulumtimit së bashku me temat e hulumtimit, pyetjet e detajuara të hulumtimit, pjesëmarrësit, metodat shkencore të aplikuara, tabelat, grafikët, analizën e të dhënave, gjetjet e përdorura dhe konkluzionet. Sugjerime dhe rekomandime janë një tjetër pikë kryesore e punimit.
- Referencat: Do të bëhet sipas sistemit APA.
- Gjatësia e rekomanduar e punimit: 6-10 faqe.

PUBLIKIMI:

Të gjitha punimet e prezantuara do të botohen në përmbledhjen e Konferencës me ISBN. Në ditën e Konferencës do të shpërndahet së bashku me materialet e tjera të konferencës. Do të ketë botim me ISSN dhe do të publikohen edhe online.

DATA TË RËNDËSISHME:

- Thirrja e Parë e Konferencës Ndërkombëtare: 1 Maj 2018.
- Thirrja e Dytë e Konferencës Ndërkombëtare: 20 maj 2018.
- **Dorëzimi i Abstraktit : deri në 20 qershor 2018**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

- Njoftimi i pranimit të Abstraktit: 20 korrik 2018.
- Dorëzimi i abstraktit: 10 Tetor 2018.
- Konferenca Ndërkombëtare: 15 nëntor 2018.

GJUHA E KONFERENCËS:

- Abstrakt në shqip ose anglisht.
- Prezantime në shqip ose anglisht.
- Punimi përfundimtare në shqip ose anglisht.

TARIFAT E REGJISTRIMIT:

Konferenca nuk ka pagesë regjistrimi për pedagogët dhe studiuesit e universiteteve dhe qendrave kërkimore shkencore, si dhe për studentët e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Për të ftuarit e tjerë pagesa për pjesëmarrjen në conference është 3000 Lekë. Për hollësitë tjera organizative dhe teknike do të njoftoheni në vazhdimësi nga grupi organizator.

JU MIRËPRESIM!